



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FINIQ-DROPULL

Nr. 164 prot.

Finiq, më 16.03.2023

NJOFTIM PËR PUNËSIM

PËR POZICIONIN MËSUES PROFILI Histori-Gjeografi në Gjuhën Greke
NË AFATIN: 17.03.2023 - 28.04.2023

Pozicioni i punës: SH.M.B. "LEFTER TALO" LIVADHJA

Në mbështetje të Ligjit 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 28.01.2020 "Për Miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore", Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë" ndryshuar me Udhëzimin nr.28, datë 03.08.2022 të MAS "Për një ndryshim në udhëzimin nr.12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar", Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar" ndryshuar me Udhëzimin nr. 25, datë 01.08.2022 të MAS "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.30, datë 12.09.2018, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar", Udhëzimit nr.20, datë 19.07.2022 "Për përcaktimin e lëndëve mësimore që zhvillohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën amtare nga nxënësit e pakicave kombëtare në arsimin bazë në Shqipëri", Urdhërit nr.531, datë 09.09.2022 të MAS "Për përcaktimin e planit mësimor për pakicat kombëtare në arsimin bazë",

ZVAP FINIQ - DROPULL

NJOFTON:

Kërkesën për personel mësimor nga Shkolla e Mesme e Bashkuar "Lefter Talo" Livadhja për pozicionin mësues profili Histori-Gjeografi në Gjuhën Greke, si pasojë e krijimit të vendit vakant për afatin: 17.03.2023 - 28.04.2023

Adresa: Rruga "Foiniqeon" Finiq email: ZVAFiniqdropull@arsimi.gov.al Tel: 0682046580

ZVAP Finiq – Dropull njofton se Komisioni i Vlerësimit në ZVAP do të vijojë me procedurën e duhur ligjore për plotësimin me mësues profili **Histori-Gjeografi në Gjuhën Greke, në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Lefter Talo” Livadhja me kontratë me afat të caktuar**, sipas Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë” ndryshuar me Udhëzimin nr.28, datë 03.08.2022 të MAS “Për një ndryshim në udhëzimin nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar””.

Kandidatët e interesuar jashtë portalit, që plotësojnë kërkesat për pozicionin e mësuesit si më sipër, të paraqesin dokumentat përkatëse pranë ZVAP Finiq-Dropull deri më dt. 17.03.2023, ora 09:30, për trajtim sipas legjislacionit në fuqi nga Komisioni i Vlerësimit të ZVAP.

DREJTORI

Ziso ELUCI

